



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 08/L - 183

PËR MBËSHTETJEN E PUNËVE PUBLIKE

Kuvendi i Republikës së Kosovës:

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR MBËSHTETJEN E PUNËVE PUBLIKE

KAPITULLI I
DISPOZITAT HYRËSE

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të krijojë një mekanizëm për kompensimin deri në një masë të caktuar të rritjes së çmimeve të materialeve ndërtimore dhe punëve përcjellëse në kontratat për punë të lidhura në mes të Autoriteteve Kontraktuese dhe Operatorëve Ekonomikë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Neni 2
Fushëveprimi

Ky ligj zbatohet vetëm për kontratat aktive të punës të lidhura para datës 1 Prill 2022 në pajtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë kuptimet si në vijim:

1.1. **Çmimi Bazë** – Çmimi i një materiali ndërtimor siç është përcaktuar në kontratën e nënshkruar në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik.

1.2. **Çmimi i Tregut** – Çmimi i një materiali ndërtimor sipas vlerës aktuale në treg.

1.3. **Fatura Bazë** – Fatura e lëshuar nga Operatori Ekonomik e llogaritur me Çmime Bazë.

1.4. **Fatura e Kompensimit** – Fatura që lëshohet krahas Faturës Bazë dhe që përmban Kompensimin për Inflacion.

1.5. **Norma për Kompensim** – Përqindja e llogaritur nga Autoriteti Kontraktues sipas formularit të publikuar nga Ministria përkatëse për Financa për kërkesën e pranuar nga Operatori Ekonomik.

1.6. **Kompensimi për Inflacion** – Shuma e përlogaritur nga Autoriteti Kontraktues kur shumëzon normën e kompensimit me vlerën e Faturës Bazë.

2. Të gjitha shprehjet e tjera të përdoruar në këtë ligj kanë kuptimin sipas përkufizimeve të vendosura në Ligjin përkatës për Prokurim Publik dhe Ligjin përkatës për Menaxhimin e Financave Publike.

KAPITULLI II MËNYRA E KOMPENSIMIT TË INFLACIONIT NË MATERIALE NDËRTIMORE

Neni 4 Materialet dhe punët përcjellëse për kompensim për inflacion

1. Kompensimi për inflacion realizohet vetëm për materialet ndërtimore të cilat janë ndikuar nga inflacioni. Kjo listë e materialeve ndërtimore përfshin:

1.1. Bitumin dhe emulzionin;

1.2. Çimenton;

1.3. Hekurin dhe produktet e tij;

1.4. Plastikën dhe produktet e saj;

1.5. Betonin dhe produktet e tij;

- 1.6. Zhavorin;
- 1.7. Aluminin;
- 1.8. Bakrin; dhe
- 1.9. Zinkun.

2. Kompensimi për inflacion realizohet edhe për punët përcjellëse si makineritë, fuqia punëtore dhe të tjera.

Neni 5

Kushtet dhe kufizimet për kompensimin për inflacion

1. Të drejtë për të dorëzuar kërkesë për kompensim për inflacion kanë Operatorët Ekonomikë të cilët dëshmojnë se materialet ndërtimore, sipas paragrafit 1 të nenit 4, të cilat janë pjesë e kontratës së punës, kanë pësuar rritje të çmimeve.
2. Ky ligj zbatohet vetëm për kontratat aktive të punës me vlerë të mesme dhe të mëdha të lidhura në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik.
3. Ky ligj ka efekt vetëm për punët e certifikuar dhe faturat e dorëzuara nga Operatori Ekonomik tek Autoriteti Kontraktues prej datës 1 prill 2022 deri më 30 Qershor 2023.
4. Të gjitha kontratat e punës të cilat janë shkëputur dhe/ose janë subjekt i procedurave gjyqësore për anulim, ndryshim të çmimit apo të ngjashme, përjashtohen nga mundësia për kompensim për inflacion.
5. Përjashtim nga paragrafi 4 i këtij neni përbëjnë Operatorët Ekonomikë të cilët mund të dëshmojnë që kanë tërhequr padinë pranë organeve gjyqësore apo arbitrazhi, dhe që kontrata është ende në fuqi.

Neni 6

Administrimi i kërkesave për kompensimin për inflacion

1. Çdo Operator Ekonomik që pretendon se i plotëson kushtet, sipas nenit 5 të këtij ligji, mund të dorëzojë kërkesë për kompensim për inflacion tek Autoriteti Kontraktues për punët që parashihen të përfundohen brenda afateve të përcaktuara sipas paragrafit 3 të nenit 5 të këtij ligji.
2. Operatori Ekonomik së bashku me kërkesën dorëzon dokumente që dëshmojnë nevojën për kompensim për materialet përkatëse dhe çmimet e tregut për to.
3. Autoriteti Kontraktues jo më larg se shtatë (7) ditë kalendarike nga pranimi i kërkesës, nxjerr vendimin aprovues, vendim aprovues me ndryshime ose refuzues lidhur me kërkesën për kompensim për inflacion.

4. Vendimi aprovues përmban normën për kompensim sipas kërkesës nga Operatori Ekonomik, vendimi aprovues me ndryshim përmban normën për kompensim sipas ndryshimeve të bëra nga Autoriteti Kontraktues gjatë shqyrtimit të kërkesës, kurse vendimi refuzues përmban arsyet për refuzim.

5. Vendimet nga paragrafi 3 të këtij neni, mund të dorëzohen për rishqyrtim nga ana e Operatorit Ekonomik tek Autoriteti Kontraktues brenda pesë (5) ditëve kalendarike.

6. Në rastin e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike e nxjerr vendimin përfundimtar mbi çështjen e kompensimit për inflacion.

Neni 7

Raportimi dhe monitorimi i vendimeve

1. Çdo javë, Autoriteti Kontraktues njofton Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për kontratat e punës për të cilat, gjatë asaj jave, ka pranuar kërkesa për kompensim për inflacion sipas paragrafi 1 të nenit 6 të këtij ligji.

2. Brenda tre (3) dite kalendarike pas nxjerrës së vendimit për aprovim ose refuzim të kërkesës për kompensim për inflacion, Autoritetet Kontraktuese i vendosin të gjitha vendimet në platformën elektronike të prokurimit publik. Çdo kërkesë për pagesë për kompensim për inflacion pa e respektuar këtë paragraf konsiderohet si e pavlefshme.

3. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik monitoron nëse të gjitha vendimet për kompensim për inflacion janë të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik.

4. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik përpilon raporte periodike çdo muaj mbi të dhënat e gjeneruara dhe evidentuara nga vendimet për kompensim për inflacion përmes platformës elektronike të prokurimit. Për qëllime informimi, raportet e tilla dorëzohen tek Ministria përgjegjëse për Financa.

Neni 8

Përlllogaritja e kompensimit për inflacion

1. Ministria përgjegjëse për Financa publikon formularin me formulë përkatëse në bazë të së cilit përlllogaritet norma për kompensim. Ky formular publikohet brenda shtatë (7) ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Formula përmban pozicione të caktuara për secilin material ndërtimor dhe një pozicion për punët përcjellëse ku përmes peshës së secilit pozicion, peshës së tyre në kontratën e punës, dhe çmimit bazë e çmimit të tregut për to përcaktohet norma për kompensim.

3. Autoriteti Kontraktues i vendos të dhënat sipas kërkesës së Operatorit Ekonomik në formularin sipas paragrafit 2 të këtij neni, dhe nxjerr normën e kompensimit për atë kërkesë.

4. Përqindja maksimale e kompensimit për punët përcjellëse, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij ligji, nuk mund të kalojë vlerën e inflacionit sipas Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit të publikuar nga Agjencia përkatëse për Statistika.

5. Pavarësisht normës për kompensim të përcaktuar sipas formularit, norma për kompensim nuk mund të kalojë njëzetë për qind (20%) të vlerës totale të faturës bazë.

Neni 9 Menaxhimi i faturave

Operatori Ekonomik për të gjitha punët e çertifikuara dorëzon tek Autoriteti Kontraktues faturën bazë dhe faturën e kompensimit.

KAPITULLI III ZBATIMI, MONITORIMI DHE DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 10 Regjistrimi dhe raportimi i shpenzimeve

1. Ministria përgjegjëse për Financa, përcakton një kod ekonomik të dedikuar në kuadër të planit kontabël, me qëllim të regjistrimit dhe raportimit të shpenzimeve shtesë të krijuara nga kompensimi për inflacion.
2. Autoriteti Kontraktues realizon procesin e shpenzimit të faturës së kompensimit, nga ndarjet aktuale buxhetore të projektit, në kodin përkatës ekonomik, sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Zyra Kombëtare e Auditimit, në pajtim me mandatin ligjor, i vendos fokus në planin e auditimit shpenzimeve të krijuara në kodin ekonomik të dedikuar për qëllime të këtij ligji.

Neni 11 Të drejtat dhe detyrimet e pa-afektuara

Kompensimi për inflacion nuk i afekton të drejtat dhe detyrimet e tjera kontraktuale të lidhura ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe është në fuqi deri më 30 Qershor 2023.

Ligji Nr. 08/L-183
08 nëntor 2022

Glauk Konjufca

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës